



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1625/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Shtepiaku” Sh.p.k, me NRB:71010511, me seli në Prishtinë, rruga “Rexhep Krasniqi”, kundër debitorit “Arda Rei Group” Sh.p.k., me NRB:71203840, me seli në Prishtinë, rruga “Hyrije Hana” p.n, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti të Përgjithshëm, KPPP.nr.1298/22 të datës 19.09.2023, me datën; 22.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit “Arda Rei Group” Sh.p.k., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti të Përgjithshëm, KPPP.nr.1298/22 të datës 19.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti të Përgjithshëm, KPPP.nr.1298/22 të datës 19.09.2023 e ka hedhur si të pasafatshëm prapësimin e debitorit “Arda Rei Group” Sh.p.k, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.18/21 të datës 18.01.2021, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Driton Govori.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktvendimin e shkallës së parë të priset dhe çështja të kthejet në rivendosje.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 18.01.2021, ka paraqitur propozim për përmbaremore ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.17-SHV04-001-384 e datës 21.01.2017, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të këtij urdhri që në emër të borxhit sipas faturave të lartcekura, t'ia paguaj shumën prej 278.00 € si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbaremit me dhunë.

Përmbareuesi Privat, Driton Govori me seli në Prishtinë duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lejuar urdhrin përmbaremore P.nr.18/21, të datës 18.01.2021

Kundër urdhrin përmbaremore debitori ka paraqitur prapësim me arsyetimin se fatura e cila i është bashkangjitur propozimit nuk cilësohet si dokument i besueshëm si dhe deklaron që është arritur parashkrimi absolut i kërkesave të kreditorit. Andaj i ka propozuar Gjykatës ta aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin, anuloj urdhrin përmbaremore si dhe të detyrohet kreditori t'i mbuloj të gjitha shpenzimet përmbaremore. Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim brenda afatit ligjor. Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendim si të pasafatshëm

për arsyet si në vijim: Sipas vlerësimit të Gjykatës, debitori Urdhrin Përmbarrimor P.nr.18/21 të datës 18.01.2021, të Përmbarruesit Privat Driton Govori, e ka pranuar me datë 28.01.2021, e cila vërtetohet nga fletë kthesa për dorëzim personal të përmbarruesit privat që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është ushtruar me datën 09.02.2021. Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore përcaktohet se “Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarrues ose urdhrin përmbarrues”, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se “Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.” Andaj duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori urdhrin përmbarrimor P.nr.18/21 të datës 18.01.2021 e ka pranuar me datën 28.01.2021, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 29.01.2021 rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 04.02.2021. Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 09.02.2021 në zyrën e përmbarruesit privat, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar edhe në mënyra tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me pesë (5) ditë vonesë.

Dhoma e Shkallës së Dytë, e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton edhe sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPKsë.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur ka hudhë poshtë prapësimin e debitorit “Arda Rei Group” Sh.p.k., i paraqitur kundër Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 18/21 të datës 18.01.2021, të lejuar nga Përmbarruesi Privat Driton Govori, si i pasafatshme, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se debitori “Arda Rei Group”, ka pranuar Urdhrin Përmbarrimor

18/21 të datës 18.01.2021, me datën 28.01.2021 (ditë e ejte) me çka vërtetohet nga fletë dërgesa për dorëzim personal e Përmbauesit Privat, ndërsa debitori ka paraqitur prapësim me datë 09.02.2021 (ditë e marte) fakt ky që vërtetohet përmes komunikimit elektronik-email, sepse shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me 5 (pesë) ditë vonesë.

Sipas nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbaimore përcaktohet se: "*Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbaues ose urdhrin përmbaues*", ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se: "*Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme*". Andaj duke marrë parasysh faktin se debitori Urdhrin Përmbaimore P.nr 18/21 të datës 18.01.2021, e ka pranuar me datë 28.01.2021 (ditë e ejte) ndërsa afati për paraqitjen e prapësimin ka filluar të rrjedhë nga data 29.01.2021 (ditë e premte) kalendari i muajit Janar-2021, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimin ka qenë data 04.02.2021(ditë e ejte). Nga kjo rezulton se debitori ka paraqitur ankesë 5 ditë me vonesë, pra jashtë afatit kohor

Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 09.02.2021, e cila vërtetohet nga fletë dërgesa për dorëzim personal e Përmbauesit Privat, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me 5 (pesë) ditë vonesë. Pra, prapësimi i debitorit është ushtruar jashtë afatit të përcaktuar konform nenit 70 të LPP-së.

Gjykata e shkallës së dytë analizoi edhe pretendimet e debitorit në ankesë se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar drejt çështjen e afatshmerise, mirepo pretendimeve ankimore të debitorit janë vetëm në mënyrë deklarative duke mos e argumentuar pretendimet e tij me asnjë prove të vetme, andaj pretendimet e debitorit si të tilla nuk ndikojnë në një vendosje ndryshe për çka kjo gjykatë i refuzoi si të pabazuara, ndërsa aktvendimin e gjykatës e shkallës së parë e vërtetoi.

Kompetenca e Dhomës se Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendim

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1625/23 me datë 22.03.2024

Gjyqtarja
Franciska Zhitija Ymeri